7. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Rrogozhinës. Regjistrimi i ri i pasurisë, 3254 (tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) m², tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Rrogozhinës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË RROGOZHINË

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja në m ²	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	N/K	Zona kadastrale
1	Rifat Kasa	760	551	418760	249/1	3235
2	Skënder Kasa	800	551	440800	249/2	3235
3	Beqir Kasa	578	551	318478	249/3	3235
4	Tahir Toska	1116	551	614916	216	3235
	SHUMA	3254		1792954		

VENDIM
Nr.209, datë 25.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA ZGJERIMI I STADIUMIT, NË BASHKINË E RROGOZHINËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i stadiumit, në bashkinë e Rrogozhinës, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Masa e shpërblimit të pronarit të pasurisë, pronë private, me sipërfaqe 80 (tetëdhjetë) m², tokë/arë, dhe 40 (dyzet) m² ndërtesë, që shpronësohet, është 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë.

3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Rrogozhinës, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të

këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Rrogozhinës.

6. Afati i përfundimit të punimeve, në objektin “Zgjerimi i stadiumit” të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki, për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Rrogozhinës. Regjistrimi i ri i pasurisë, 80 (tetëdhjetë) m², tokë/arë, dhe 40 (dyzet) m², ndërtesë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Rrogozhinës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E STADIUMIT TË RROGOZHINËS, NË BASHKINË RROGOZHINË

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja në m ² truall	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Pasuria nr.	Zona kadastrale
1	Rifat Toska	80	2500	200.000	323	3234
Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja në m ² ndërtesë	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Pasuria nr.	Zona kadastrale
1.	Rifat Toska	40	40.000	1 600 000	288	3234
	Vlera totale			1 800 000		

VENDIM
Nr.211, datë 25.2.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.610, DATË 12.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRANSFERIMIN E PASURIVE, TROJE DHE OBJEKTE, ME INTERES VENDOR, NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “k”, 5, 8 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.610, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave, përmasat e pronës Fonder-Mek sh.a., zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohet si klasa të veçanta)

Bashkia: Tiranë

Fusha e përdorimit të pronës: zhvillimi ekonomik

A		B					C			
Nr. rend	Zona kadastr. indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Emërtesa e pronës vend ndodhja/ shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vend ndodhja e komponentëve përbërëse	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhënat e tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
983	8170 M.N-19, 20	10/19	Fonder-Mek sh.a		Ish-Komb. autotraktor, Shkozet	144349 (136700)	Nr.në hartë	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Nga verif. në ZRPP Ka rezultuar sip (136700 m ²) Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag. Produkt të gashëm	Ish-komb. aut Shkozet	1091,56	38+38/1	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Zdrukthari	Ish-komb. aut Shkozet	267,2	39	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag Zdruktharisë	Ish-komb. aut Shkozet	204	40	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/19		Reparti mekanik	Ish-komb. aut Shkozet	8545,5	2+2/3	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohet si klasa të veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 M.N-19, 20	10/9		Rep. Rula tamburo	Ish-komb. aut. Shkoze	771.6	5+5/1	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Kaldaja oxhaku	Ish-komb aut. Shkoze	850.1	3+4+4/1	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Paisje jashtë standardit	Ish komb. aut. Shkoze	561	7+7/1	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Rep. gizës sferoidale	Ish komb. aut. Shkoze	623	8	Bashkia	Fon-Mek sh.a	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Fonderia gizes	Ish komb. aut. Shkoze	7805.6	9+9/4+9/5+9/ 3+9/6+9/1+8/ 1+8/3+8/2+14+15+16	Bashkia	Fon-Mek sh.a	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Rep. modelet e plasmasit	Ish komb. aut. Shkoze	820	9/2	Bashkia	Fon-Mek sh.a	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Rep Konacanes	Ish komb. aut. Shkoze	1871.2	21+21/1+21/ 2+21/3+12+13+13/1	Bashkia	Fon-Mek sh.a	Pronë shtetërore

	8170 M.N-19, 20	10/9		Salla e kompresorëve 1	Ish komb. aut. Shkoze	216	19	Bashkia	Fon-Mek sh.a	Pronë shtetërore
--	-----------------------	------	--	------------------------------	--------------------------	-----	----	---------	--------------	------------------

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohet si klasa të veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 M.N-19, 20	10/9		Salla e kompresorëve 2	Ish komb. aut. Shkoze	299	22	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Mag. lëndës së parë	Ish komb. aut. Shkoze	1461.5	20+34	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Mag pranë kompres	Ish komb. aut. Shkoze	303	23	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Mag pajisjeve elektrike	Ish komb. aut. Shkoze	414	24		Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Mag. rezervuarve të ujit	Ish komb. aut. Shkoze	442.1	27/1+27/2+27/3 27/4+25	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170	10/9		Rep. Modelet	Ish komb.	882.9	28+28/1	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore

	M.N-19, 20			e drurit	aut. Shkoze					
	8170 M.N-19, 20	10/9		Mag. kimikatetve plasmasit Depo helmesh	Ish komb. aut. Shkoze	505.6	29+17	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Fonderi çeliku	Ish komb. aut. Shkoze			Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore Është e rrafshuar

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohet si klasa të veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 M.N-19,	10/9		Rep. kaolines	Ish komb. aut. Shkoze			Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore Nuk ekziston

	20									
	8170 M.N-19, 20	10/9		Parku i automjeve	Ish komb. aut. Shkoze	583.56	37+37/1	Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore
	8170 M.N-19, 20	10/9		Sip funksionale	Ish komb. aut. Shkoze	115830.58 (108181.58)		Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë shtetërore (108181,58
	8170 M.N-19, 20	10/97 10/98 10/99		Sip. Funksionale kthyer me v. nr. 5075 Të gjyk. në shkall. së I	Ish komb. aut Shkoze	4379 m²			Fon-Mek sh.a.	Pronë private 10/100
	8170 M.N-19, 20	10/119 10/120		Sip.Funksionale Kthyer me VKKK nr.810/96	Ish komb. aut. Shkoze	3270 m²		Bashkia	Fon-Mek sh.a.	Pronë private

VENDIM
Nr.212, datë 25.2.2009

**PËR TRANSFERIMIN E DISA PASURIVE, TRUALL, NË PRONËSI TË BASHKISË SË
ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “k”, 5, 8 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë së Elbasanit të pasurive truall, në zonën kadastrale 8525, parcelat nr.13/36, 13/57, 13/58, 13/59, 13/72, 13/76, pjesë të pronës nr.639, në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë e Elbasanit, për ngritjen e banesave sociale, sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Bashkisë së Elbasanit nuk i lejohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të këtyre pasurive apo dhënia në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen kryetari i bashkisë Elbasan dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohet si klasa të veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
639	8525		Troje dhe sheshe midis pallateve lagjja “5 Maji”	Shesh	Lagjja “5 Maj”	42077.26	Shesh	Bashkia Elbasan	Bashkia Elbasan	Numrat e pasurisë
	I-9.10 K-9.10 J.-10.11 H-9.10			Truall	Lagjja “5 Maj”	253294.57	Truall	Bashkia Elbasan	Bashkia Elbasan	13/64, 13/70, 13/74 13/76, 13/77, 13/81, 13/84, 13/124, 13/131, 18/33, 18/54, 19/7, 19/8, 19/11, 20/3, 21/19, 21/20, 21/21, 22/62, 22/87, 22/89, 22/127, 23/9, 26/87, 11/53, 13/1, 13/9, 13/10, 13/11, 13/12, 13/15, 13/17, 13/19, 1321, 13/22, 13/24, 13/26, 13/28, 13/32, 13/33, 10/35, 13/36, 13/38, 13/40, 13/41, 13/43, 13/44, 13/46, 1348, 13/49, 13/50, 13/51, 13/52, 13/53, 13/55, 13/57, 13/58, 13/59, 13/72, 13/86, 13/87, 13/88, 13/90, 13/94, 13/95, 13/96, 13/98, 13/100, 13/101,13/102, 13/103, 13/105, 13/106, 13/107,13/109, 19/117, 13/122,13/124, 13/126, 13/128,13/112, 13/131, 13/140, 14/1, 14/3, 14/5, 14/6, 14/8, 14/10, 14/12, 14/14, 14/15, 14/16, 14/17, 14/18, 14/19, 14/21, 14/23, 14/25, 14/27, 14/31, 14/33, 14/42, 14/46, 14/47, 14/48, 14/49, 14/52, 14/37, 14/54
										14/56, 14/57, 14/58, 14/60, 14/61, 14/63, 14/67,14/69, 14/71,

										14/74, 14/76, 14/79, 14/81, 14/83, 14/84, 14/86, 14/89, 14/90, 14/91, 14/93, 14/97,14/99, 14/101, 14/102, 14/104, 14/106, 14/108, 14/109, 14/111, 14/112, 14/115, 14/117,14/118, 14/120, 14/122,14/124, 14/125, 15/7, 15/9, 15/11, 15/12, 15/14, 15/16, 15/18, 15/20, 15/23, 15/28, 15/29, 15/31, 15/33, 15/34, 15/35, 15/36, 15/37, 15/39, 15/41, 15/43, 15/44, 15/45, 15/47, 15/50, 15/52, 15/54, 15/57, 15/59, 15/61, 15/64, 15/66, 15/69, 15/75, 15/78, 15/1. 15/81, 15/94, 16/1, 16/2, 16/3, 16/4, 16/5, 16/7, 16/8, 16/9, 16/11, 16/13, 16/15, 16/17, 16/19, 16/20, 16/22, 16/23, 16/26, 16/27, 1628, 16/29, 16/30, 16/33, 16/37, 16/39, 16/41, 16/43, 16/44, 16/47, 16/49, 16/51, 16/53, 16/55, 16/57, 16/58, 16/61, 16/64, 16/66, 16/68, 16/70, 16/72, 16/74, 16/75, 1677, 16/78
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

VENDIM
Nr.213, datë 25.2.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KURJAN, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kurjan, të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kurjan, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.36, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kurjan të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kurjan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kurjan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
11-15	Prona që përdoren për realizimin e veprimeve social-kulturore e sportive.	Në pronësi
17-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
21-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
28,29,35,37,38,40,41,43, 44,46,47,48,49,50,52,53,55,56	Troje të lira dhe hapësira dhe hapsira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
60-65	Varrezat publike	Në pronësi
66-72	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
91,96,111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta)	Në pronësi
112-115	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizime	Në pronësi

VENDIM
Nr.214, datë 25.2.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS
KUSHOVË, TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kushovë, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kushovë, të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.3, datë 4.1.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kushovë, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kushovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kushovë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i trasferimit
1-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
9-17	Varrezat publike	Në pronësi
18-89	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillim ekonomik.	Në pronësi
105-109	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizime	Në pronësi
110-135, 137-169	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
248-264	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
265,266, 267,269, 271,273,275,99-104	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
268, 270, 272, 274	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM
Nr.11, datë 2.3.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TERMOCENTRALI VLORË“ SHA PËR KRYERJEN E

AKTIVITETIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa a, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 5, germa a, 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a. dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë e Termocentrali Vlorë sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

- Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike.

- Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- kryerjen e pagesës së regjistrimit të aplikimit për licencë pranë ERE-s (neni 9, pika 3, germa d),

Është i lidhur me arsye objektive që dalin jashtë mundësive të kompanisë për ta paraqitur atë brenda afatit të shqyrtimit të aplikimit në ERE, si dhe me çeljen e fondit përkatës nga KESH sh.a.

- Licencimi i kësaj shoqërie lidhet ngushtë me kryerjen e një investimi publik përmes ngritjes së termocentralit në zonën e Vlorës dhe përbën një nga investimet më të mëdha për sektorin elektroenergjetik, i kryer me kontributin e përbashkët të Bankës Botërore, BERZh, BEI, marrëveshje këto të ratifikuara nga Kuvendi.

Për gjitha sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Termocentrali Vlorë sh.a. për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike për një afat 30 vjet.

2. Shoqëria Termocentrali Vlorë sh.a. të kryejë pagesën e regjistrimit të aplikimit për licencë menjëherë me çeljen e fondit për këtë pagesë nga KESH sh.a.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM **Nr.12, datë 3.3.2009**

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë

elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative, të miratuar me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 3.3.2009, në kuadër të ushtrimit të autoritetit për zbatimin e metodologjive të vendosjes së tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, pasi shqyrtoi kërkesën e METE-s nr.1930, datë 27.2.2009, si dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave, Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për miratimin e Deklaratës Rregullatore,

VENDOSI:

1. Miratimin e Deklaratës Rregullatore sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shfuqizimin e vendimit nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e Deklaratës Rregullatore”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.13, datë 3.3.2009

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S “GJENDJA E SEKTORIT TË
ENERGJISË DHE VEPRIMTARISË SË ERE-S GJATË VITIT 2008”

Në zbatim të neneve 9 dhe 10 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror” neni 13, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 3.3.2009, mbasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë elektrike dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2008”, të paraqitur nga kryetari i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2008”, që do t’i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (Raporti bashkëngjitur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË
Nr.475/6, datë 27.2.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore” që preken nga ndërtimi i linjës 220 kv TEC i ri Vlorë –nënstacioni 220/110/35 kv Babicë Vlorë.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: KESH sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË LINJËS
DYFISHE 220 KV TEC I RI –NËNSTACIONI 220/110/35 KV BABICË VLORE”.**

RRETHI: Vlorë

KOMUNA: Qendër

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore, arë

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit të linjës: Kultura bujqësore, ullinj

SHPRONËSIMI DEFINITIV											
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. pasurisë	Sipërfaqja e shpronësuar në m²	Çmimi lekë/m²	Çdëmtim ullinj	Vlera totale në lekë	Adresa
									Vlera në lekë		
1	Nasho	Sotir	Daiu	Arë	2765	391/18	96,04	309,3		29,705	Narte
2	Theodhori		Dupi	Arë	2765	397/18	60,84	309,3		18,818	Narte
3	Filip		Thanasko	Arë	2765	170/3	56,25	309,3		17,398	Narte
4	Miranda		Allushi	Ullishte	8605	1/2	56,25	592,7		33,340	Pusi i Mezinit
5	Egerem		Saliu	Ullishte	8605	1/2	156,25	592,7	48,000	140,610	Pusi i Mezinit
6	Osmen		Haxhiu	Ullishte	8605	2/1	56,25	592,7	48,000	81,340	Pusi i Mezinit
7	Braho		Rushani	Ullishte	8605	33/1	67,24	592,7	48,000	87,853	Pusi i Mezinit
8	Riza		Taushani	Ullishte	8605	33/2	67,24	592,7		39,853	Pusi i Mezinit
9	Lefter		Leka	Ullishte	8605	3	70,56	592,7		41,820	Pusi i Mezinit
10	Isa	Gani	Mezuraë	Arë	1061	76/2	70,56	592,7		41,820	Babic e Vogël
11	Hyri		Buzi	Ullishte	1060	76	67,24	455	48,000	78,594	Babic e Madhe
12	Kasim	Abaz	Qemali	Arë	1060	99	231,04	455		105,123	Babic e Madhe
13	Hamza	Din	Haredini	Arë	1060	119/14	67,24	455		30,594	Babic e Madhe
14	Sokol	Avdul	Avduli	Arë	1060	342/8	104,04	455		47,338	Babic e Madhe
15	Osmen		Haruni	Arë	1060	330	110,25	455		50,164	Babic e Madhe
16	Ahmet	Abaz	Hasani	Arë	1060	330	182,25	455		82,924	Babic e Madhe

KËRKESE

Shtetësja Ollga Petro Shuraja (Perici), lindur në fshatin Cerjë, Leskovik, e banuese në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Mili Janaq Perici.

**KËRKUESJA
Ollga Petro Shuraja (Perici)**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.4.2009
Doli nga shtypi më 4.4.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë